

Parat dhe tatimet

[Konto / Qarkullimi i pagesave](#)

[Tatimet](#)

[Borxhet](#)

[Të jetosh me pak para](#)

Konto / Qarkullimi i pagesave

Kush fiton para dhe duhet të paguajë faturat, ka nevojë për një llogari bankare ose postare. Për blerje, janë shumë të përhapura debitkartat ose kreditkartat

Kontoja

Në Zvicër, pothuajse çdo banor ka një llogari bankare. Pagat e punonjësve zakonisht transferohen në llogarinë bankare. Shumë banka dhe posta ofrojnë llogari për personat privatë. Hapja e një llogarie është zakonisht falas. Megjithatë, pastaj ndodhin shumë pagesa të ndryshme. Meqenëse tarifat, interesat dhe shërbimet ndryshojnë nga ofruesi në ofrues, është mirë të bëni krahasime. Për hapjen e një llogarie, në çdo rast, kërkohet një pasaport ose një dokument tjetër identiteti.

Debitkartat / Kreditkartat

Kush ka një llogari, zakonisht merr një kartë llogarie për të tërhequr para. Kjo kartë është e vlefshme vetëm në bankën që e lëshon. Megjithatë, bankat ose posta ofrojnë karta debiti (siç është Maestro), me të cilat mund të tërhiqën para në të gjithë bankomatët dhe mund të paguhet në shumicën e dyqaneve. Këto karta mund të përdoren edhe jashtë vendit. Varësisht nga karta, ka kosto të ndryshme. Kartat e kreditit mund të kërkohen nga shumë ofrues të shërbimeve të tilla. Kushtet dhe kostot janë shumë të ndryshme, prandaj është e vlefshme të krahasohen. Tani pagesa me kartë debiti ose krediti është shumë e përhapur.

Të paguash faturat

Faturat zakonisht dërgohen me një fletë pagese me postë, me e-mail ose përmes eBill. Ka mënyra të ndryshme për t'i paguar ato:

- E-Banking: Pagesa përmes internetit është shumë e përhapur dhe e sigurt.
- Në sportel: Me fletën e pagesës mund të bëhen pagesa me para të gatshme në postë. Kush ka një llogari postare, mund të bëjë pagesën direkt nga llogaria. Klientët e bankave mund të kryejnë pagesa edhe në sportelin e bankës.
- Me postë: Urdhrat e pagesës mund të dërgohen edhe me letër në bankë ose postë.
- Informacione më të hollësishme jepen nga banka ose posta.
- Mënyrat e pagesës për faturat e përsëritura:
Debitim direkt (LSV): Kjo metodë është shumë e përshtatshme, pasi faturat tërhiqen automatikisht nga llogaria. Informacione mbi këtë ofrohen nga lëshuesi i faturës ose nga banka/posta.
- Nëse shuma e faturës është gjithmonë e njëjtë (p.sh. qiraja), mund të krijohet një urdhër i përhershëm për pagesë në bankë ose postë.
- Me eBill, faturat merren direkt përmes online banking të bankës suaj. Ju vendosni nëse dhe kur dëshironi të paguani faturën dhe mbani kontroll të plotë mbi pagesat tuaja. Nëse dëshironi, mund të autorizoni faturat për pagesë automatike.

Faturat janë gjithmonë të shoqëruara me një afat pagese. Nëse ky afat nuk respektohet, mund të ketë pasoja: Një procedurë përmbartimore është e mundur.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-ar.ch/sq/parat-dhe-tatimet/konto-qarkullimi-i-pagesave

Tatimet

Ngarkesat tatimore në Zvicër janë të varura nga vendbanimi. Tatimet më të rëndësishme për personat privatë janë të ardhurat, pasuria dhe tatimi në vlerën e shtuar.

Sistemi tatimor

Në Zvicër, taksat vendosen nga Federata, kantonet, komunat dhe kishat e shtetit (Landeskirchen). Bëhet dallimi ndërmjet taksave direkte dhe indirekte. Taksat direkte më të rëndësishme janë tatimi mbi të ardhurat dhe tatimi mbi pasurinë, të cilat duhet të paguhen drejtpërdrejt nga tatimpaguesit. Taksat indirekte përfshijnë tatimin mbi vlerën e shtuar, taksën e duhanit dhe taksën e vajit mineral. Këto taksa përfshihen në çmimin e mallërave. Duke qenë se kantonet dhe komunat janë përgjegjëse për shumë taksa, ka dallime të mëdha në shumën e taksave direkte midis vendbanimeve. Çiftet e martuara tatimohen së bashku.

Tatimi burimor

Të huajve, të cilët janë të regjistruar si banorë të rinjë, tatimi mbi të ardhurat e tyre tërhiqet drejtpërdrejt nga paga e tyre (taksë burimore, Quellensteuer). Regjistrimi bëhet nga punëdhënësi për punonjësit.

- Shuma e tatimit varet nga të ardhurat, statusi martesor (beqar, i martuar, i divorcuar) dhe numri i fëmijëve. Ndryshimet duhet të paraqiten menjëherë.
- Nga tatimi burimor është e mundur të bëhën zbritje të ndryshme, për shembull, për depozita në shtyllën e tretë, kamatat e borxhit, kostoja e lartë mjekësore, etj.
- Kush ka pasuri duhet t'i deklarojë ato dhe ta paguajë veçmas tatimin për to.
- Nëse fitoni më shumë se 120,000 franka zviceriane në vit, duhet të paraqisni një deklaratë tatimore (tatimimi i rregullt).
- Kush është i martuar me një bashkëshort(e) me pasaportë zvicerane ose leje qëndrimi C, gjithashtu duhet të plotësojë një deklaratë tatimore (tatimimi i zakonshëm).

Enti tatimor kantonal (Kantonaes Steueramt) ofron informata të mëtutjeshme lidhur me tatimin burimor.

Përgjegjësia për tatimin në burim: Franziska Götti, 071 353 63 16, quellensteuer@ar.ch

Tatimi i rregullt

Personat me pasaportë zvicerane ose leje qëndrimi C tatimohen normalisht (ordentliche Besteuerung). Tatimi nuk zbritet nga të ardhurat. Ata duhet të plotësojnë një deklaratë tatimore dhe tatimin ta paguajnë me faturë. Plotësimi i deklaratës tatimore është gjithashtu edhe për zviceranët i ndërlikuar. Prandaj është e këshillueshme të merret ndihmë kur për herë të parë bëhet plotësimi i deklaratës tatimore. Administrata tatimore kantonale është përgjegjëse për tatimin e rregullt. Në Appenzell Ausserrhoden, pavarësisht detyrimit për tatimin në burim me lejen B, ju keni mundësinë të kërkonit më vonë tatimin e zakonshëm. Tatimi në burim me një tarifë fikse do të vazhdojë të zbritet drejtpërdrejt nga paga juaj. Pas kërkesës, ju mund të deklaroni zbritje që nuk përfshihen automatikisht në tatimin në burim. Pasi të keni zgjedhur tatimin e zakonshëm, duhet të deklaroni çdo vit.

- Kontributet në shtyllën e 3-të
- Interesat e kredive
- Shpenzimet e larta mjekësore
- Shpenzimet efektive të profesionit
- Shpenzimet për kujdesin ndaj fëmijëve (tatim i veçantë)
- Shpenzimet e formimit të vazhdueshëm që i keni paguar vetë
- etj.

Afati i dorëzimit: Kërkesa duhet të dorëzohet deri më 31 mars të vitit pasardhës (data e dorëzimit elektronik). Ky afat nuk mund të zgjatet.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-ar.ch/sq/parat-dhe-tatimet/tatimet

Borxhet

Nëse nuk i paguani faturat në kohë, mund të ketë pasoja serioze. Në raste problemesh financiare, qendrat e këshillimit për borxhe ofrojnë mbështetje.

Vërejtjet dhe mbledhja e borxhit

Ai që nuk paguan faturat me kohë, në raste normale merr një vërejtje të parë dhe një të dytë për pagesën. Por, kreditorët gjithmonë e kanë mundësinë të nisin proces ekzekutimi. Në këtë rast, borxhliu merr një urdhër pagese nga zyra kompetente e ekzekutimit të borxheve (Betreibungsamt). Kjo çon në kosto. Ai që mendon se ekzekutimi nuk është ligjor mund të kundërshtojë me një kundërgargument në zyrën e kompetente të ekzekutimit të borxheve (Rechtsvorschlag). Kujdes: Ekzekutimi mund të çojë në bllokimin e pagave ose objekteve me vlerë. Gjithashtu, ekzekutimet regjistrohen në regjistrin e ekzekutimeve (Betreibungsregister) (edhe nëse në fund paguani). Kjo mund të jetë një problem në rast të kërkimit të një banese, ndër tjera.

Borxhet

Kush ka shqetësime financiare ose borxhe, mund të drejtohet në një qendër këshillimi për borxhe (Schuldenberatungsstelle). Atje merr ndihmë. Ekspertët bashkë me këruesit e këshillave shqyrtojnë situatën dhe kërkojnë zgjidhje. Organizata Caritas ofron këshillim anonim përmes telefonit: "SOS-Schulden" Beratungs-Hotline - Linja këshilluese, telefoni 0800 708 708 (falas). Nëse është e nevojshme, do t'ju drejtojnë në një vend tjetër këshillimi. Ndihmë dhe informacion të dobishëm mund të merrni në zyrat rajonale të shërbimeve sociale.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-ar.ch/sq/parat-dhe-tatimet/borxhet

Të jetosh me pak para

Jeta në Zvicër është relativisht e shtrenjtë. Prandaj, mund të jetë e vlefshme për të blerë disa artikuj të përdorur. Kush është në vështirësi për para, mund të blejë lirë në shitore veçanta.

Artikujt e përdorur

Në Zvicër ka shumë shitore me mallëra të përdorura (Brockenhäuser). Atje, artikujt e përdorur mund të blihen me një çmim shumë të arsyeshëm. Në tregje të veçanta, edhe individë privat ofrojnë gjëra të përdorura. Disa shembuj janë tregjet - pazaret, tregjet e rrobave, tregjet e skive, dhe kështu me radhë. Edhe portalet në internet janë gjithashtu shumë të pëlqyera për blerjen dhe shitjen e artikujve të përdorur.

Sporti / Kultura / Arsimimi

Me kartën Kulturlegi, njerëzit me pak para marrin zbritje çmimi në ngjarje sportive, kulturore dhe arsimore. Karta mund të kërkohet në Caritas. Caritasi informon për këtë dhe verifikon të drejtën për të marrë kartën Kulturlegi.

Tregu i Caritasit

Njerëzit me pak para mund të blejnë ushqime dhe produkte për nevojat e përditshme në shitoret e Caritasit (Caritas Markt) me çmime shumë të favorshme. Për këtë, kërkohet një kartelë e veçantë, e cila duhet kërkuar në Caritas. Caritasi informon dhe verifikon të drejtën për ta marrë këtë kartelë. Në Herisau ka një dyqan nga fondacioni Tosam.

Ndihma shtetërore

Ai që nuk ka para të mjaftueshme për të jetuar, në shumë raste ka të drejtë për ndihmë nga shteti. Kështu për shembull, mund të kërkojë zbritje në pagesat e sigurimeve shëndetësore, Winterhilfe, ose stipendi për shkollim. Në situata të veçanta jetësore mund të merren para nga sigurimet sociale ose nga ndihma sociale.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-ar.ch/sq/parat-dhe-tatimet/te-jetosh-me-pak-para